




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE

Nr. 1345/12 Prot.



Tiranë, më 10/10.2024

Lënda: **Dërgim Oponence Teknike**


DREJTORISË SË PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT

Tiranë

Në vijim të kërkesës suaj me Nr.1354/30 prot, datë.24.09.2024, protokolluar me tonën me Nr.1345 prot, datë.24.09.2024 “Kërkesë për kryerjen e Oponencës teknike”, po ju dërgojmë në 2 kopje, oponencën teknike të projektit të zbatimit me objekt: “ Rrjeti ujitës në formë shiu”, Bashkia Tiranë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Artan SHKREDI



OPONENCË TEKNIKE
PËR PROJEKT ZBATIMIN E OBJEKTIT
“RRJETI UJITËS NË FORMË SHIU”, BASHKIA TIRANË

POROSITËS: BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT

PROJEKTUES : SHOQËRIA “ZENIT &CO” SHPK

GRUPI PROJEKTIMI

- | | |
|----------------------------------|--------------------|
| - Ing. Ndërtimi. Rexhep TARBA | Nr.Lic.K.1596/4 |
| - Ing.Elektrik. Kristaq ZHUPA | Nr.Lic.E.0848/2 |
| - Ing.Hidroteknik. Merita MENGRI | Nr.Lic.H/T. 0142/5 |
| - Ing. Topograf. Lulzim VRAPI | Nr.Lic. T.0039/3 |

Bëhet kjo oponencë teknike për projekt zbatimin e objektit: **“RRJETI UJITËS NË FORMË SHIU”, BASHKIA TIRANË**, mbështetur në Ligjin Nr. 8402 dt.10/09/1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Neni 6; në V.K.M. Nr.9 dt.11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet ti nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë, si dhe procedurat që duhet të ndiqen në këto raste”; në Urdhërin e Ministrit Nr.243 dt. 12.06.2019 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit” si dhe në Vendimin Nr.354, dt.11/05/2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projekte, mbikqyrje dhe kolaudim”.

Grupit të oponencës i janë vënë në dispozicion këto materiale:

Kërkesa për kryerjen e Oponencës Teknike për objektin nga Drejtorja e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjellbërimit me Nr.1354/ 30 Prot dhe Datë .24.09.2024, protokolluar me tonën me Nr.1345 Prot., Datë 24.09.2024.

Marrëveshja midis Drejtorise se Përgjithshme te Pastrimit dhe Gjellbërimit dhe Institutit të Ndërtimit me Nr.1354 /31 Prot, date. 01.10.2024 dhe me Nr.1345/1Prot.,date. 01.10.2024 të Institutit të Ndërtimit, ku Tarifa e shërbimit për kryerjen e oponencës teknike është është **82, 677 (tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë me TVSH.**



- Detyra e Projektimit
- Projekti Zbatimit
- Preventivi i punimeve
- Raport teknik
- Specifikime teknike
- Grafik Punimesh
- Analiza teknike te cmimeve
- Relacion Gjeologjik
- Relacion Sizmik

Materiali i dorëzuar, do të konsiderohet i mirëqenë dhe i saktë nga ana ligjore, absolutisht në përgjegjësi të dorëzuesit dhe do të shërbejë si bazë për vlerësimin e projektit dhe hartimin e Oponencës Teknike

1. DETYRA E PROJEKTIMIT

Detyra e projektimit është një material prej 12 fq format A4, hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, firmosur nga grupi i punës dhe miratuar nga Drejtori Znj. Liri Qoshi.

Në këtë detyrë projektimi jepen përshkrimi i gjendjes ekzistuese, vendndodhja, Standartet në projektim, realizimi i projektit.

Objekti ndodhet përgjatë Lumit Lana, Tiranë

Duke u nisur nga mbjelljet e shumta të realizuara në sgmentin ura e maternitetit “Koco Gliozheni” deri në mbikalimin e Shkozës, ka dalë domosdoshme ujitja e tyre, metoda e përzgjedhur është menduar metoda e spërkatjes.

Kërkesat e projektit

- Projektin e zbatimit (Projektin skemes se vaditjes, detajet e punimeve civile, detajet e punimeve elektro-mekanike, detajet e punimeve elektrike, detajet e punimeve mekanike)
- Raporti teknik (duke përfshirë anekset mbi studimet perkatese)
- Specifikimet teknike te pergjithshme dhe veçanta për zërat e punimeve që do të kryhen.
- Grafikon e punimeve.
- Preventivi i plote i punimeve me çmime dhe pa çmime
- Metodologjia e përgatitjes se preventivit per zerat e punes sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 13.4.2023, për sistemin e integruar të informatizimit të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.



- Të paraqiten detaje (hollësi) të ndryshme.
- Të gjitha fletët e projekteve të jenë saktësisht të dimensionuara, të kuotuar, me akset në të dy drejtimet, dhe saktësisht të dallueshme dhe lexueshme.
- E gjithë metodologjia e projektimit do të bazohet referuar Kushteve Teknike të Projektimit sipas VKM nr.83, date 10.2.2021.

Projektuesi duhet të parashikojë instalimin e rrjetit elektrik trefazor me fuqi të tillë që të sigurojë funksionimin normal të pompave në pusë. Në rast se del e nevojshme që të ndërtohet kabinë ere elektrike , duhet të parashikohet në preventiv. Panelet e komandimit të vendosen të rinjsipas standarteve bashkëkohore.

Standartet në Projektim

Projekti duhet të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektimin, që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve , madje ehe atyre të zbatimit. Projektuesi mund të rekomandoj edhe prezantimin e standarteve të reja , për përafrimin me normat e BE.së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

Konkluzion

Detyra e projektimit ka kërkesa të qarta përsa i përket realizimit të një projekti teknik të zbatimit.

2. RAPORTI TEKNIK

Raporti Teknik është paraqitur në 35 faqe format A4, hartuar nga shoqëria projektuese, firmosur nga Ing.Arqile Peri.

Në këtë raport teknik jepen të dhëna mbi vendodhjen projektit, të dhëna mbi gjendjen ekzistuese, të dhëna topografike, të dhëna mbi identifikimin edhe menaxhimin e bimëve, Llogaritjet hidraulike si dhe zgjidhjet teknike.

2.1 RAPORTI TOPOGRAFIK

Raporti topografik është pjesë e raportit teknik. Në këtë raport jepet metodologjia e punimeve topografike, pozicioni topografik i zonës, materialet bazë që u përdorën për rilëvimin topografik, instrumentat e përdorur, përshkrimi i punës së kryer, monografia e pikave fikse.

Zona e projektit është pjesë e Bashkisë Tirane, e shtrire përgjate Lumit Lana duke filluar nga rrethrotullimi I Unazes se Madhe Shkoze e deri ne uren e kalimit prane Bulevardit Bajram Curi

Nga ana altimetrike kemi te bejme me nje terren fushor. Kuota maksimale është 155m dhe kuota minimale është 120m pra nje disnivel ne total te zones rreth 35m.

Gjatesia e nderhyrjes referuar detyres se projektimit është rreth 1.7km ne te dy anet e Lumit Lana



Eshte perdorur harta topografike te pergatitur nga instituti topografik i ushtrise (ITU) azhornimi i fundit ne vitin 1987 qe jane hartat baze deri me sot dhe qe nezonat malore dhe kodrinore sherbejne mjaft mire per shkak te ndryshimeve pothuajse te vogla te terrenit .
Matjet gjeodezike per realizimin e projekt zbatimit jane kryer duke u mbeshtetur ne nje poligon me 2 pika baze,dhe pika poligoni te shtrire pergjate objektit ne forme boshti.

Matjet poligonale dhe ato te pikave detaje jane kryer me me GPS ROVER TRIMBLE R8s te cilet teknikisht sigurojne matjet e kendeve e largesive me saktesine e nevojshme per projektimin e veprave hidroteknike.

Rilevimi eshte bere ne sistemin UTM Zone 34N meqenese ne gps kemi te instaluar software te cilet na e bejne te mundur te punojme direkt ne kete sistem koordinativ.

Me kete sistem mund te percaktohet lehtesisht kordinatat gjeodezike per cdo pike mbi siperfaqen tokesore nepermjet perdorimit te GPS si dhe perdorimin e hartave dixhitale ortofoto sidomos per pozicion planimetrik.

3. PROJEKTI HIDROTEKNIK I RRJETAVE INXHINIERIKE

OBJEKTI: “NDËRTIM RRJET UJITËS NË FORMË SHIU PËRGJATË LUMIT LANA,,

Në detyrën e projektimit të hartuar nga drejtorja e përgjithshme e pastrimit dhe gjelbërimit në bashkinë Tiranë kërkohet të hartohet projekti për objektin: “ **Ndërtim Rrjet Ujitës Në Formë Shiu Përgjatë Lumit Lana** ,, duke parë mbjelljet e shumta të realizuar në segmentin nga Ura e Maternitetit “Koço Glozheni” deri në mbikalimin e Shkozës është e domosdoshme ujitja e tyre. Për një ujitje sa më uniform është menduar metoda e vaditjes me spërkatje dhe pika e cila përbën sot metodën më të përdorur dhe më efektive ku më kryesore është kursimi i ujit. Sistemi i ujitjes parashikohet te realizohet me linjë kryesore dhe sekondare duke shfrytëzuar pusët ekzistuese në zonë.

GJENDJA EKZISTUESE DHE ZGJIDHJA TEKNIKE E PROJEKTI

Pusët ekzistues tek Materniteti i Ri përballë njëri tjetrit, nuk janë në gjendje pune pasi janë pa pompa dhe kanë shumë pak ujë. Rrethrotullimi Ura Shkozë, janë tre puse, dy nga të cilët janë përballë njëri tjetrit në hyrje të rrotullimit të cilët kanë prurje të vogël uji por janë në gjendje pune. Pusi i tretë në cep të këtij rrotullimi në krah të majtë kundër rrjedhës, ka nevojë për linjën e trefazorit dhe panel pasi pusi ka prurje të madhe. Pjesa që do të mbulohet me këtë rrjet të rri ujqor që përlllogaritet afërsisht në 37.400 m² e cila do ti nënshtrohet paisjes me këtë rrjet të ri ujitës sipas të gjithë normave bashkëkohore të fundit. Për marrjen e ujit të nevojshëm referuar detyrës së projektimit dhe inspektimeve në objekt konfirmohet që është mundësia e marrjes së 3 puse shpimi të pozicionuara pranë rrethrotullimit të materniteti Kico Glozheni.



Në projekt vihet re që pusët janë të hapura dhe është e nevojshme të bëhet zëvendësimi i pompave zhytëse pasi aktualet janë jashtë përdorimit dhe jofunksionale. Të gjithë pusët kanë të njëjtat parametra teknike si më poshtë:

- Thellessia e pusit 140m
- Thellessia e vendosjes së pompës 130m
- Hpompës= 150m
- Prurja e pusit $Q=0.6l/sec$

Për këto parametra ekzistues është parashikuar vendosja e pompave të reja zhytëse 3-fazore. Në total parashikohet zëvendësimi i 3 pompave zhytëse. Për përcaktimin e nevojës për ujë janë bërë identifikimi i bimësisë. Janë dhënë sasia e bimëve të cilat ndodhen në këto segmente dhe në bazë të tyre është përcaktuar dhe sasia e ujit për vaditje.

Me qënë se në zonë u identifikuan 3 puse të cilat do të përdoren për vaditjen e zonës projekti merr në konsideratë ndarjen për vaditje në 3 zona ku secili prej puseve të bëjë mbulimin përkatës.

Projekti parashikon vendosjen në secilën prej zonave të 3 depozitave inoksi , të prodhuara të gatshme me volum secili prej 10.000 litra. Harxhimi dhe mbushja e tyre do të jetë në funksion të përdorimit të ujit për vaditje, por parashikohet që pompa zhytëse e pusit të punojë të paktën 7 orë në ditë për të mbuluar nevojat minimale për vaditje.

Linjat vaditëse për zonat në studim janë parashikuar të jenë tuba polietileni PE 100 PN 10.

Për sistemin vaditës parashikohet vendosja e 3 pompave centrifugale me të dhënat si mëposhtë:
 $Q=6 l/sec$ $H=50m$

Cdo sistem pompash do të shoqërohet me panelin elektrik të komandimit dhe programatorin përkatës të sistemit të vaditjes. Rezervuari i parashikuar në projekt është rezervuar i gatshëm metalik me $D=2100mm$ dhe $L=3000 mm$, formë cilindrike me spesor llamarine $t=5mm$.

Nga materialet e vëna në dispozicion Oponenca vëren se :

- Projektuesi paraqet një relacion teknik për zonën që projektohet për materialin dhe dimensionimin e tubacioneve të vaditjes duke marrë për bazë normat dhe standartet e projektimit .
- Është paraqitur planimetria e shpërndarjes së sistemit të vaditjes që do të ndërtohet duke paraqitur rrjetin e ri të sistemit të vaditjes , tub polietilen , i dimensionuar si dhe zonën e mbulimit.
- Projekti është shoqëruar me profilin gjatësor të secilës linjë.
- Në materialet e vëna në dispozicion janë paraqitur llogaritjet hidraulike.
- Në projekt është paraqitur planimetria teknike e sistemit hidraulik të rrjetit të vaditjes.



KONKLUZION:

Projekti i rrjetave inxhinierike të kanalizimit të ujrave të zeza dhe të bardha si dhe të furnizimit me ujë për objektin: “Ndërtim Rrjet Ujitës Në Formë Shiu Përgjatë Lumit Lana , në përgjithësi është hartuar drejt në përputhje me KTP dhe KTZ që janë në fuqi në vendin tonë, si dhe normave dhe standarteve europiane të projektimit .

4. PROJEKTI ELEKTRIK

Ne detyren e projektimit kërkohej që Projektuesi duhet të parashikojë instalimin e rrjetit elektrik trefazor me fuqi të tillë që të sigurojë funksionim normal të pompave në puse. Në rast se del e nevojshme që të ndërtohet kabinë e re elektrike, duhet të parashikojë projekt/preventivi i saj. Panelet e komandimit të vendosen të rinj sipas standarteve bashkëkohorë.

Projektuesi duhet të sigurojë miratimin e projekteve elektrike në OSHEE , si dhe të përcaktojë edhe pikën e lidhjes me energji elektrike, nga rrjeti i fuqisë (kabina ose transformatori i zonës).

Projektuesi duhet të parashikojë vendosjen e matësit elektrik trefazor, lidhjen e kontratës me OSHEE, si dhe vlerën e përafërt të shtrimit të kabllit nga sahati deri te pika e lidhjes së miratuar si dhe vlera e tarifave të OSHEE.

Projekti elektrik I paraqitur jep

Planvendosjen e objektit

Blllok skemat e funksionimit te sistemit te vaditjes

Instalimet e pompes zhytесе

Sistemin e rezervuareve te vaditjes

Panelin elektrik te sistemit te vaditjes

Sistemin e tokezimit

Ne shenimet teknike jepen lista e materialeve qe do te perdoren.

Rezervuari i parashikuar ne projekt eshte rezervuar i gatshem metalik me Diameter D-2100mm dhe Gjatesi L-3000 mm , forme cilindrike me spesor llamarine t=5mm e blastenuar dhe e lyer ne fabrike me boje hypoxide nga brenda dhe nga jashtë.

Ne specifikimet teknike jepen te dhena ne lidhje me karakteristikat e pajisjeve elektrike, pajisjet mbrojtесе, komanduese, sinjalizuese, tipet e kablllove te pompes, etj.

Konkluzion: Vizatimet e projektit elektrik jane paraqitur sakte.



5. SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimet teknike janë paraqitur në 40 fletë formati A4, hartuar nga shoqëria projektuese, firmosur nga Ing.Arçile Peri.

Ato janë ndarë në kapituj si më poshtë:

- Punime të përgjithshme
- Punime toke dhe punime rruge
- Punime betoni dhe betoni te armuar
- Linjat e FU – tubat -shtrimi dhe Testimi
- Valvolat dhe Hidrantet
- Pusetat
- Paneli elektrik

Konkluzion:

Specifikimet teknike ne pergjithesi janë të plota, per te gjitha punimet e parashikuara ne projekt.

6. PREVENTIVI I PUNIMEVE

Preventivi për objektin: **“RRJETI UJITËS NË FORMË SHIU”**, BASHKIA TIRANË, është paraqitur në 3fq A4, hartuar nga shoqëria projektuese, firmosur nga Ing.Arçile Peri.

Vlera totale e punimeve eshte **27, 340, 136.55 me tvsh**. Në kete vlere eshte marre fondi rezerve 5 % si dhe vlere e Tvsh 20% si dhe pajisjet .

Konkluzion:

- Preventiv eshte hartuar sipas platformës e-albania në përputhje me VKM Nr.216, datë 13.04.2023 **“Për Krijimin dhe Funkionimin e sistemit të Integruar për informatizimin e Manualit të çmimeve për Zërat e Punimeve në Ndërtim”**.
- Për zërat që në preventiv është shënuar An (analizë) janë paraqitur të detajuara analizat e cmimeve nga kontrolli i të cilave shohim se në to janë marrë parasysh të gjithë elementët e kostos.
- Përgjegjësia e volumeve dhe cmimeve të marra në preventiv është e preventivuesit.
-
- Sipas grafikut të punimeve, kohëzgjatja e punës është 3 muaj.



PËRFUNDIM

Nga studimi i materialeve të vëna në dispozicion, për projektin e zbatimit të objektit “RRJETI UJITËS NË FORMË SHIU”, BASHKIA TIRANË , me porositës Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit , konkludohet se: **Projekti është konceptuar drejt, konkluzionet e dhëna në këtë oponencë teknike të plotësohen gjatë zbatimit të punimeve.**

GRUPI I OPONENCËS

Ing. Konstruktor. Valbona PONDE

Nr.Liç.K.1562 /3

Ing.Hidroteknik. Ina SHENA

Nr.Liç.K.2695



SHEFE E SEKTORIT TË OPONENCAVE

Ing. Mamica SHEHI

DREJTORE DREJTORIE

Ing.Valbona PONDE